



REPUBLIKA E SHQIPERISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Dokument parlamentar

Tiranë më 04.02.2019

RAPORT

për zgjedhjen e 3 anëtarëve të Këshillit Drejtues të RTSH

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, u mbledh më datë 4 shkurt 2019, për të zhvilluar dëgjuesat publike me kandidatët e propozuar sipas ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në RSH”, për plotësimin e tre vendeve vakante në KDRTSH.

Në komision morën pjesë anëtarë të shumicës dhe opozitës parlamentare.

Në Këshillin Drejtues të RTSH, janë krijuar tre vende vakante si pasojë e përfundimit të mandatit të tre anëtarëve, sipas vendimeve përkatëse të Kuvendit¹

Bazuar në vendimet nr.1/2017 dhe 2/3/4/2018 të Komisionit , gjatë vitit 2018 janë paraqitur propozimet e subjekteve propozuese që përcakton ligji 97/2013.

Për secilin vend vakant , u propozuan 4-5 kandidatë, duke përmbushur kështu kushtin ligjor sipas nenit 94, pika 3, e ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në RSH”, i ndryshuar”, i cili përcakton se : “Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik bën përzgjedhjen sipas përcaktimeve të neneve 93 dhe 97 të këtij ligji, mes të paktën 4 kandidaturave për çdo vend anëtarit të KDRTSH-së”.

Komisioni konstatoi legjitimitimin e kandidaturave të propozuara nga subjektet që ngarkon ligji, në përputhje me nenin 94 , pika 2 e ligjit 97/2013 “ Për mediat audiovizive në RSH”, duke konkluduar se kandidaturat janë të propozuara nga subjektet që kërkon ligji dhe në përputhje me natyrën dhe fushën e subjekteve që kërkon ligji.

Në përputhje me përcaktimet e nenit 94 , nenit 93 dhe nenit 97 të ligjit 97/2013, si dhe bazuar në përcaktimet e nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni zhvilloi procesin e

¹ Vendi vakant si pasojë e përfundimit të mandatit tre vjeçar të anëtarit të zgjedhur me vendim të Kuvendit nr 101, datë 4.12.2014, Z.Helidon Haliti (*kandidaturë e mbështetur nga shumica*)
Vendi vakant si pasojë e përfundimit të mandatit tre vjeçar të anëtarit të zgjedhur me vendim të Kuvendit nr 56, dt.30.4.2015, Z.Pashk Përvathi(*kandidaturë e mbështetur nga opozita*)
Vendi vakant si pasojë e përfundimit të mandatit tre vjeçar të anëtarit të zgjedhur me vendim të Kuvendit nr 57, dt.30.4.2015, Z.Artan Peqini (*kandidaturë e mbështetur nga opozita*)

shqyrtimit të kandidaturave , duke zbatuar fazat ligjore të listuara në pikën 4, të nenit 94, të ligjit 97/2013, duke vlerësuar përmbushjen e kriterëve ligjore dhe meritën e çdo kandidature,

si dhe garantimit të zhvillimit të seancave dëgjimore me çdo kandidat të vlefshëm, për të vijuar më pas me përzgjedhjen e tyre .

Nga 12 kandidatët e propozuar sipas ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në RSH”, i ndryshuar, tre kandidatë: z.Avni Nezaj, z.Sadik Spahija dhe znj.Ormina Lulanaj, u përjashtuan nga procesi i përzgjedhjes në komision, për shkak se nuk u paraqitën në seancë dëgjimore, pavarësisht konfirmimit paraprak nga ana e tyre.

Gjatë zhvillimit të dëgjesave, kandidatët shpjeguan arsyet e kandidimit të lidhura me përvojën profesionale në fushën e medias publike ose të lidhur me të, si dhe shpalosën idetë e tyre për kontributin që mund të japin në Këshillin Drejtues të RTSH. Deputetët u drejtuan pyetje disa prej kandidatëve, me fokus zhvillimin e RTSH-së gjatë periudhës së digjitalizimit, si dhe problematikat që kanë shoqëruar dhe vijnë ende në këtë proces teknologjik të mediave në vend.

Pas përfundimit të dëgjesave me secilin kandidat të paraqitur në komision, Komisioni vijoi procedurën e përzgjedhjes midis 9 kandidatëve të mbetur në garë, duke kryer përjashtimin sipas përcaktimeve të nenit 94, pika 4, gërma a) dhe b) të ligjit 97/2013, duke përjashtuar sipas rradhës një nga shumica dhe një nga opozita në komision, për secilin grup kandidatësh të propozuar sipas vakancave dhe shpalljeve përkatëse të Kuvendit.

Në çdo rast komisioni gjatë përjashtimit të kandidatëve, mbajti në vëmendje garantimin e respektimit të parimit të moscënimit të integritetit personal dhe profesional të kandidatëve si dhe ruajtjen e balancës në përbërjen e anëtarëve të KDRTSH-së sipas përcaktimit ligjor ku 5 anëtarë të përzgjedhur nga ky komision janë të mbështetur nga maxhoranca dhe 5 pesë anëtarë të përzgjedhur nga ky komision janë të mbështetur nga opozita.

Mandati i anëtarëve të rinj që do të zgjidhen nga Kuvendi **do të jetë 5 vjeçar**, në zbatim të nenit 9, pika 1, e ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në RSH”, pasi me këtë zgjedhje, bie edhe dispozita kalimtare e ligjit, përkatësisht neni 135 e tij, sipas të cilit: Vetëm “*Gjatë mandatit të parë, Kryetari, Zëvendëskryetari dhe dy anëtarë të KDRTSH-së, zgjidhen në funksion për një periudhë 5-vjeçare, 4 anëtarë për një periudhë 4-vjeçare dhe 3 anëtarë për një periudhë 3-vjeçare. Përcaktimi i mandatit të anëtarëve bëhet me short, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e veprimtarisë së institucionit*”.

Në përfundim, Komisioni, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij, votoi tre kandidatët për anëtarë të KDRTSH: z.Besnik Mustafaj, z.Edmond Tullumani dhe z.Helidon Haliti dhe i përcjell seancës plenare vendimet përkatëse për miratim.

KRYETARE
Albana VOKSHI

RELATOR
Musa ULQINI